



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRI

MIRATOHET

SOKOL OLLDASHI
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

U D H Ë Z I M

Nr.25, datë 20.10.2010

**PER VENDOSJEN E MASAVE PER IMPLEMENTIMIN E STANDARTEVE
TE PERGJITHSHME BAZE PER SIGURINE E AVIACIONIT**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, Ligjit Nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9658, datë 18/12/2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit European dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovines, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohëshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Për Krijimin e një Zonë të Përbashkët Aviacionit European;

UDHËZOJ:

Neni 1 **Objektivi**

1. Ky Udhezim vendos masat per implementimin dhe pershtatjen teknike te standarteve te pergjithshme baze te sigurise se aviacionit te cilat duhet te perfshihen ne programin kombetar te sigurise se aviacionit civil.
2. Masat e referuara ne piken 1 te ketij neni specifikohen ne Aneksin bashkelidhur ketij udhezimi, i cili perben pjese integrale te ketij akti.

Neni 2 **Perkufizime**

Per qellimin e ketij Udhezimi perkufizimet e perdorura do te kene kuptimin si meposhte vijon:

- “Programi kombetar i sigurise se aviacionit civil” nenkupton ato rregullore, praktika dhe procedura te miratuara nga Keshilli i Ministrave, per te garantuar sigurine a aviacionit civil ne territorin e vendit.
- “Autoriteti perkates” nenkupton autoritetin kombetar pergjegjes per koordinimin dhe monitorimin e implementimit te programit kombetar te sigurise se aviacionit civil.

Neni 3

Procese dhe metoda te reja teknike

1. Shteti Shqiptar mund te lejoje perdorimin e nje metode ose proces te ri teknik per kontrollet e sigurise ne vend te atyre te detajuara ne Aneks, me kusht qe te garantohet se ai:

- (a) po perdoret per te vleresuar nje menyre te re te kryerjes se kontrolleve te sigurise
- (b) nuk do te ndikojte negativisht ne nivelin e pergjithshem te arritur te sigurise.

Neni 4

Hyrja ne fuqi

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere dhe botohe ne Fletoren Zyrtare.

ANEKS

1. PERKUFIZIMET.

Termet e perdorura do te kene kuptimin si meposhte:

1.1 “AKSMA” eshte Akses Kontrolli dhe Sistemi Monitorues i Alarmit, i cili duhet te kontrolloje ne menyre elektronike aksesin e dyerve, portave dhe pikave te tjera te hyrjes qe te cojne drejtperdrejte ose jodrejtperdrejte ne zonat e kufizuara te sigurise, dhe te cilat duhet te japin alarm ne autoritetet e caktuara kur nje hyrje e paautorizuar ka ndodhur.

1.2 “Perdorues i aeroportit” eshte cdo person fizik ose juridik pergjegjes per transportin e pasagjereve, postes dhe/ose ngarkesave me mallra ne menyre ajrore, per dhe nga aeroporti ne fjale.

1.3 “Sherbimet ne toke” jane sherbimet e garantuara per perdoruesit e aeroportit sipas percaktimeve te legjislacionit ne fuqi.

1.4 “Kompani ajrore” eshte nje siperrmarje e transportit ajror me nje licence operimi te vlefshme, e cila kryen operime fluturimi.

1.5 “Paneli sherbimeve” eshte nje pike hyrje e jashtme e avionit, e cila perdoret per te garantuar sherbimet e avionit. Panele te tilla perfshijne uje, tualet, priza per shkarkime elektrike dhe ambiente te tjera per sherbimet qe kane lidhje me pjesen e jashtme.

1.6 “Avion jo ne sherbim” nenkupton nje avion i cili, ose eshte i parkuar per nje periudhe me te gjate se 12 ore, ose nuk eshte ne mbikqyrje te mjaftueshme per te zbuluar hyrjen e paautorizuar.

2. SIGURIA E AEROPORTIT

2.1. Akses kontrolli

2.1.1 Zonat e kufizuara te sigurise dhe pjese te tjera te zones ajrore

1. Autoriteti perkates duhet te garantoje qe aksesin per ne zonat e kufizuara te sigurise eshte i kontrolluar. Aty ku pjese te zones jo te kufizuar ajrore te sigurise jane afer, dhe krijojne mundesine e aksesit per ne zonat e kufizuara te sigurise, vija kufizuese dhe kontrole te mjaftueshme per te zbuluar akses te paautorizuar dhe per te marre masat e pershtatshme duhet te vendosen.

2. Autoriteti perkates qe autorizon aksesin per ne zonat e kufizuara te sigurise duhet te siguroje qe i gjithë personeli me akses per ne keto zona te zbatoje masat strikte te akses kontrollit.

Keto masa duhet te perfshijne:

- (a) personeli me karte identifikimi te aeroportit per akses ne zonat e kufizuara te sigurise duhet te jete i familjarizuar me aeroportin dhe identifikimet e miratuar jo nga aeroporti, dhe rastet kur ato mund te jene te vlefshme per akses ne zonat e kufizuara te sigurise;

- (b) personeli do të raportojë tek Autoriteti Perkatës, të gjithë personat në zonat e kufizuara të sigurisë, të cilët nuk kanë një identifikim të vlefshëm.
- (c) personeli duhet të raportojë tek Autoriteti Perkatës të gjithë automjetet e paautorizuara që janë vënë në zonat e kufizuara të sigurisë.

3. Autoriteti perkatës duhet të sigurojë në Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil që, kartat e identifikimit të aeroportit që lejojnë aksesin në zonat e kufizuara të sigurisë kontrollohen si mëposhte:

- (a) kartat e identifikimit të aeroportit duhet të kufizojnë aksesin e stafit në zonat e caktuara vetëm për nevojat operacionale;
- (b) pas mbarimit të kontratës apo ndryshimit të statusit të punëtorëve, karta e identifikimit të aeroportit duhet të kthehet tek autoritetet e aeroportit dhe të asgjësohet;
- (c) mbajtësit i kërkohet të informojë menjëherë punëdhënësin e tij dhe autoritetin për humbjen apo vjedhjen të kartës së tij të identifikimit. Pas lajmerimit, karta e identifikimit e aeroportit duhet të behet menjëherë e pavlefshme.

4. Autoriteti perkatës duhet të sigurojë që dyert e aksesit të përdorura vetëm me qëllim zbritjen nga avionit, të cilat lejojnë akses në vendqendrimin e avionit apo në zonat e kufizuara të sigurisë, duhet të rrinë të hapura vetëm gjatë procesit të zbritjes nga avionit.

5. Pikat e skanimit të sigurisë duhet të jenë të mbrojtura nga roje ose pajisje të përshtatshme të mbikqyrjes, në mënyrë që të frenohet dhe ndalojë thyerja e sigurisë në pikat hyrëse dhe dalje të kontrollit të sigurisë, dhe të rritet mbrojtja e stafit të përfshirë në procesin e skanimit.

6. Materialet e ruajtura në zonat e kufizuara të sigurisë dhe pjesë të tjera të zonës ajrore, të cilat përdoren me qëllim të procesimit të bagazheve të pasagjerëve dhe bagazheve të medha, duhet të mbrohen ose të jenë nën mbikqyrje gjatë gjithë kohës në mënyrë që të parandalohet hyrja e paautorizuar. Materialet e panevojshme duhet të eliminohen për të siguruar që ato nuk po përdoren nga persona të paautorizuar.

Sistemet e kontrollit të nisjeve dhe sistemet e check-in nëpër aeroporte duhet të kontrollohen që të parandalohen hyrjet e paautorizuara.

Check-in vetjak dhe opsionet e aplikuar të internetit të lejuara për përdorim nga pasagjerët duhet të konsiderohen si të autorizuara për akses në këto materiale ose sisteme.

2.1.2 Zonat e terminalit

Kerkesat e shtruar në pikën 2.1.1.6 duhet gjithashtu të aplikohen në zonat e terminalit që janë të hapura për publikun.

2.2 Skanimi i stafit, artikujt e mbajtur dhe automjetet

2.2.1 Skanimi i stafit dhe artikujt e mbajtur

Stafi i sigurise mund te refuzoje per hyrjen ne zonen e kufizuar te sigurise, cdo anetar te stafit qe posedon nje artikull mbi te cilin ata kane dyshime.

2.2.2 Skanimi i automjeteve

1. Automjetet duhet te ekzaminohen ne menyre qe te evidentohet nese ka artikuj te ndaluar dhe persona te paautorizuar.
2. Drejtuesi dhe cdo perdorues tjetër i automjetit nuk duhet te jete brenda ne automjet kur behet kontrolli.

2.2.3 Procedurat e sigurise per furnizimet e lengshme dhe cantat e tejdukshme

Rregulla te pergjithshme

1. "Furnizimet e lengshme" duhet te konsiderohen si lengje per shitje ne dyqanet e vendosura ose ne pjeset e zones ajrore pertej pikes ku kontrollohen biletat ose ne zonat e kufizuara te sigurise, qe nga pranimi i tyre i pare ne zonen ajrore deri ne dorezimin ne keto dyqane.
2. "Furnizimet me canta te tejdukshme" duhet te konsiderohen si canta te tejdukshme per perdorim ne dyqanet e vendosura ne pjeset e zones ajrore, mbrapa pikes ku kontrollohen biletat, qe nga pranimi i tyre i pare ne hapësirën ajrore deri ne perdorimin e tyre final.

Cantat e tejdukshme

3. Furnizimet e cantave te tejdukshme duhet te dergohen ne pako te tejdukshme tek dyqanet e vendosura ne zonat e hapësirës ajrore mbrapa pikes se kontrollit te biletave.
4. Pas marrjes nga keto dyqane dhe deri ne perdorimin e tyre perfundimtar, furnizimet e cantave te tejdukshme duhet te mbrohen nga nderhyrjet e paligjshme.

3. SIGURIA E AVIONEVE

3.1. Kontrolli dhe kerkimi i avioneve

Transportuesi ajror duhet te siguroje qe stafi qe kryen nje kerkim sigurie te avionit dhe kontrollin e sigurise se avionit duhet te njohe tipin e avionit qe po kontrollohet dhe duhet te kete kryer trajnime te pershtatshme per kryerjen e aktiviteteve te tilla.

3.1.1. Kontrolli i sigurise se avionit

Sapo kryhet kontrolli i sigurise se nje avioni, duhet te mbahet nje procesverbal nga transportuesi ajror per 24 ore ose sa kohezgatja e fluturimit, nese ai eshte me i gjate.

3.1.2. Kerkimi i sigurise se avionit

1. Sapo permbushet kerkimi i sigurise se nje avioni, duhet te mbahet nje procesverbal nga transportuesi ajror per 24 ore ose sa kohezgjatja e fluturimit nese ai eshte me i gjate.

2. Nje kerkim i sigurise se avionit duhet te kryhet ne kabinen e nje avioni te boshatisur.

3.2 *Mbrojtja e avionit*

Transportuesi ajror duhet te jete pergjegjese per mbrojtjen e avioneve te saj.

4. PASAGJERET DHE BAGAZHET E MEDHA

4.1 Skanimi i pasagjereve

4.1.1. *Artikujt e ndaluar*

1. Pasagjeret nuk lejohen te mbajne ne zonat e kufizuara te sigurise dhe kabinen e avionit artikujt qe vijojne:

(a) Armet, armet e zjarrit dhe armet e renda.

Cdo objekt i afte, ose qe duket i afte per te shkarkuar plumba ose te shkaktoje plage, duke perfshire:

- te gjitha armet e zjarrit (pistoleta, revolvere, pushke, pushke gjahu, etj)
- imitime te armeve te zjarrit
- pjese perberese te armeve te zjarrit (duke perjashtuar pajisjet teleskopike te shikimit),
- snajper, pushke, arme me sacme
- pistoleta me lazer
- pistoleta starti
- armet lodra te cdo tipi
- arme me top
- arme industriale
- harqe
- katapulta
- arme me shtize
- arme per vrasjen e kafsheve te buta
- pajisje qe te lene pa ndienja ose trondisin (arme balistike qe percojne energji elektrike)
- cakmake me formen e armeve te zjarrit

(b) Arme dhe objekte me maje dhe te mbrehta

Artikujt me maje ose me tehe te mprehta, te afta per te shkaktuar plage, perfshire:

- sopata
- shigjeta
- ganxha
- shtiza
- kazme
- patina akulli

- thika te mprehtesive te ndryshme
- thika, duke perfshire thikat e ceremonive, me teh me te gjate se 6 cm, prej metali ose cdo material tjetër, me force te mjaftueshme per tu perdorur si arme e mundshme.
- hanxhar mishi
- brisqe te hapura (duke perjashtuar brisqet e sigurt me teh te mbyllur ne pajisjen e vete)
- shpate, bastun me shpate brenda
- bisturi
- gershere me gjatesi me shume se 6 cm
- pajisje per ski
- pajisjet e nje zanatciu qe mund te perdoren si nje arme e mprehte dhe me maje (psh turiele, freze per prerjen e kutive, thika te dobishme, cdo lloj sharre, kacavide,leve, cekic, pinca,celes, pajisje saldimi).

(c) Instrumente pa maje

Cdo instrument pa maje ne gjendje per te shkaktuar plage, duke perfshire:

- shkopi i bejsbollit
- shkopi i golfit ose shkopi i gomes se policit
- shkop per kriket
- shkopat e hokeit
- lopatat per kanoa
- skateboard
- stekat e bilardos
- kallamat e peshkimit
- pajisjet e sportit te arteve marciale

(d) Substanca eksplozive dhe te djegshme

Cdo eksploziv ose supstance e djegshme e cila ve ne rrezik shendetin e pasagjereve dhe ekuipazhit ose sigurine avionit, duke perfshire;

- municione,
- detonator dhe fitila
- eksplozive dhe pajisje plasese
- falsifikime apo imitime te materialeve apo pajisjeve plasese
- mina dhe pajisje te tjera ushtarake plasese
- granata te cdo tipi
- gaz dhe bombula gazi (psh, butan,propan, acetiline, oksigjen) ne volume te medha,
- fishekzjarre dhe cdo ndezes tjetër
- shkrepse jo te sigurta
- kuti ose pajisje qe gjeneron zjarrin
- lende djegese e lengshme (psh, nafte , benzine, diesel, alkol, etanol),
- spraj aerosol i ngjyrosur
- terentine dhe hollues boje
- pije alkolike me mbi 70 % volum alkoli.

(e) Substanca kimike dhe toksike

Cdo substance kimike ose toksike e cila ve ne rrezik shendetin e pasagjereve dhe te ekuipazhit ose sigurine e avionit, duke perfshire:

- acid dhe alkal (p.sh batteri te lagura);
- lende gerryese ose substance zbardhuese (psh merkur, klorine);
- spraj gjymtues ose paralizues (psh spraj piperi, gaz lotsjelles);
- materiale radioaktive (psh izotop mjeksor ose komercial);
- helm;
- materiale te infektuara ose biologjikisht te rrezikshme (psh gjak i infektuar, baktere dhe viruse);
- materiale ne gjendje te marrin flake spontanisht;
- bombul zjarrefikese.

(f) Lengjet

Lengjet, pervec atyre ne konfeksione me te vogla se 100 ml ose te futura ne nje cante plastike te tejdukshme per rishitje, me kapacitet jo me te madh se nje liter.

Lengjet duhet te futen lehtesisht ne canten plastike, e cila duhet te jete e mbyllur plotesisht.

Lengjet, duke perfshire xhelet, pastat, locionet, perzierjet e lengjeve te ngurtesuara, dhe te presuara, psh pasta e dhembeve, xheli i flokeve, pijet, superat, shurupet, parfumet, shkumat per rroje, aerosol dhe artikuj te tjere te ngjashem.

Mund te lejohen perjashtime neqoftese lengu eshte:

1. per tu perdorur gjate udhetimit dhe eshte ose i nevojshem per qellime mjekesore ose per qellime te vecanta dietike, duke perfshire ushqimet per femijet. Kur kerkohet, pasagjeret duhet te vertetojne origjinalitetin e lengut te perjashtuar; ose
 2. blere ne zonen ajrore, mbrapa pikes se kontrollit te biletës nga dyqanet qe i jane nenshtuar procedurave te miratuara te sigurise si pjese e programit te sigurise se aeroportit, me kushtin qe lengu te jete i paketuar ne nje cante qe eshte e tejdukshme dhe ka prova te bindshme qe eshte blere ne ate aeroport, ne ate dite;
 3. blere ne zonen e kufizuar te sigurise nga dyqanet qe i jane nenshtuar procedurave te miratuara te sigurise si pjese e programit te sigurise se aeroportit;
 4. blere ne nje aeroport tjetër, me kushtin qe lengu te jete i paketuar ne nje cante qe eshte e tejdukshme dhe e vertetuar bindshem qe eshte blere ne hapësiren ajrore te atij aeroporti ne ate dite;
 5. blere ne bordin e nje avioni te nje transportuesi ajror, me kushtin qe lengu te jete i paketuar ne nje qese qe eshte e tejdukshme dhe vertetuar bindshem qe eshte blere ne bordin e atij avioni ate dite;
2. Nje pasagjer mund te perjashtohet nga kerkesat e pikes 4.1.1.1. nese garanton qe;

(a) AAC eshte informuar me perpara dhe ka dhene leje qe artikujt mund te mbahen;dhe;

(b) Kapiteni i avionit eshte informuar per pasagjerin dhe artikujt e ndaluar qe ai/ajo po mban. Kur eshte e nevojshme artikujt e ndaluar duhet te vendosen ne kushte te sigurta.

3. Lista e artikujve te ndaluar sipas pikes 4.1.1.1 dhe informacioni per perjashtimin e lejuar duhet ti vihet ne dispozicion publikut.

4. Stafi i sigurise duhet te beje perpjekje te medha per te informuar pasagjeret per keto artikuj perpara se ata ta kene perfunduar proceduren e kontrollit te bagazheve.

5. Me perjashtim te artikujve te ndaluar ne piken 5.1.3.1, artikujt e ndaluar ne pikat 4.1.1.1 ose 4.1.1.4 mund te mbahen ne bagazhet e medha, duke garantuar qe pasagjeret te mos kene akses te pasurvejuar tek keto bagazhe qe nga pika qe bagazhi eshte kontrolluar deri ne piken qe merret ne mberritje.

6. Stafi i sigurise mund te refuzoje aksesin per ne zonen e kufizuar te sigurise dhe ne kabinen e ndonje avioni te ndonje pasagjeri qe zoteron ndonje artikull qe nuk perfshihet ne pikat 4.1.1.3 mbi te cilin kane dyshime.

4.1.2 Masat e sigurise per pasagjeret e mundshem problematik

1. Masa specifike te sigurise perfshihen ne transportin ajror per grupet e pasagjereve te mundshem problematik si vijojne;

(a) Te debuarit;

— persona qe jane pranuar ligjerisht nga autoritetet e nje shteti ose qe kane hyre ne nje shtet ne menyre te paligjshme, dhe qe ne nje kohe te mevonshme jane urdheruar zyrtarisht nga autoritetet te largohen nga ai shtet.

(b) Persona te papranueshem;

— persona hyrja e te cileve ne nje shtet eshte refuzuar nga autoritetet kompetente dhe qe po transportohen mbrapsht ne shtetin e tyre te nisjes, ose ne ndonje shtet tjeter ku keta persona jane te pranueshem.

(c) Persona nen kujdestari ligjore;

— persona qe jane ose nen arrest ose te denuar nga ndonje gjykate dhe duhen transportuar.

2. Autoritetet kompetente duhet te lajmerojne transportuesin ajror perkates, ne nje kohe te mjaftueshme me shkrim kur ato planifikojne te transportojne pasagjere te mundshem problematik.

3. Njoftimi me shkrim per transportuesin ajror dhe per pilotin ne komande duhet te permbaje detajet e meposhtme:

— identitetin e personit;

— arsyet per transportim;

— emrin dhe titullin e shoqeruesit, nese ka;

— vleresimin e rrezikut nga autoriteti kompetent (duke perfshire arsyet per shoqerim apo jo shoqerim),

— masa paraprake per vendin e uljes, nese eshte e nevojshme; dhe

— natyren e dokumentave ne dispozicion.

4. Masa specifike te sigurise parashikohen per pasagjeret e padisplinar.

Pasagjeret e padisplinar jane personat qe kryejne ne bordin e nje avioni civil, nga momenti kur dera e avionit eshte e mbyllur para ngritjes deri ne momentin kur rihapet pas uljes, nje nga aktet e meposhtme:

- sulm, kercenim, veprime te paramendura qe rrezikojne rregullin, sigurine ose pronen e Personave;
- frikesim, kercenim ose nderhyrje nderkohe qe anetaret e ekuipazhit kryejne detyren ose kufizim i aftesive te tyre per te kryer detyren;
- pakujdesi ose demtim i avionit, pajisjeve te tij, apo strukturave ndihmese dhe ekuipazhit te tilla qe rrezikojne rregullin dhe sigurine e avionit ose te perdoruesve te tij;
- komunikimi i informacionit i cili eshte i ditur qe eshte i rreme, por qe rrezikon sigurine e avionit ne fluturim;
- mosbindje ndaj urdhrave te ligjshme ose instruksioneve per sigurine dhe operacioneve efikase te detyrueshme.

5. Persona nen kujdestari ligjore duhet te jene gjithmone te shoqeruar.

4.2. Ndarja e pasagjereve

Ne rastin kur nje pjese e pajisjeve te terminalit ajror, e cila eshte e vendosur midis pikave te skanimit te sigurise dhe pikes se imbarkimit ne avion, eshte perdorur nga pasagjeret ne ardhje te paskanuar, kjo zone duhet te kontrollohet per te siguruar qe anje artikull i ndaluar nuk ka mbetur mbrapa, perpara hyrjes ne bord se pasagjereve te skanuar.

4.3 Skanimi i bagazheve te kabines

1. Te gjitha lengjet duhet te paraqiten ne pikat e skanimit per kontroll.
2. Kompjuterat portative dhe artikuj te tjere te medhenj elektrik duhet te hiqen nga bagazhet e kabines perpara skanimit dhe duhet te skanohen vec e vec.
3. Palltot dhe xhaketat e pasagjereve duhet te skanohen si pjese te ndara nga bagazhet e kabines.

5. BAGAZHET E MEDHA

5.1. Skanimi i bagazheve te medha

5.1.1. Bagazhet e medha te shoqeruara

1. Transportuesit ajrore duhet te siguroje qe cdo pasagjer te udhetoje ne te njejtin fluturim sikuresse bagazhet e tyre te kontrolluara. Ne rastin kur nuk ndodh keshtu, bagazhet e medha duhet te konsiderohen si te pashoqeruara.

2. Programi Kombetar i Sigurise se Aviacionit Civil permban procedura te detajuara per menyren e permbushjes se objektiveve te skanimit ne rast te deshtimit te pajisjeve skanuese.

5.1.2. Bagazhet e medha te pashoqeruara

Nje transportues ajror qe pranon bagazhe te pashoqeruara nga nje transportues tjetër ajror, duhet te marre nje relacion te shkruar qe kontrolltet e sigurise jane kryer per keto bagazhe perpara pranimit per imbarkim.

5.1.3 Artikujt e ndaluar per bagazhet e medha

1. Artikujt e meposhtem nuk duhet te perfshihen ne bagazhet e medha:

- eksplozive, duke perfshire lende plasese, fitila, granata, mina;
- gazra, duke perfshire propanin dhe butanin;
- lengje te djegshme, duke perfshire benzine dhe metanol;
- substanca te ngurta te djegshme dhe reaktive, duke perfshire magnezin, shkrepsat dhe ndezes te ndryshem,
- oksidues dhe perokside organike, duke perfshire cngjyroses dhe cante veglash per makineri;
- substanca toksike ose infektive, duke perfshire helm per minj dhe gjak te infektuar;
- materiale radioaktive, duke perfshire izotop mjekesor apo komercial;
- lende gerryese, duke perfshire merkurin dhe bateri makinash;
- perberes te sistemit te karburantit te makinave te cilat permbajne dhe karburant.

2. Lista e artikujve te ndaluar te pikes 5.1.3.1 duhet te jete e disponueshme per publikun ne agjensite e transportuesve ajrore dhe ne vende te tjera te pershtatshme.

3. Autoritetet aeroportuale duhet te bejne perpjekje te aresyeshme per informimin e pasagjereve per keto artikuj.

4. Personeli i sigurise mund te refuzoje transportimin e bagazheve qe permbajne artikuj qe nuk perfshihet ne piken 5.1.3.1 per te cilet kane dyshime.

5.2 Mbrojtja e bagazheve te medha

1. Aksesit ne zonat e sistemimit dhe ruajtjes se bagazheve duhet te jete i limituar vetem per ate pjese te personelit qe ka nevoja operative per te hyre ne ato zona. Ketu perfshihet ajo pjese e stafit qe eshte e perfshire ne imbarkim, zbarkim dhe mbrojtjen e bagazheve si dhe personat e autorizuar nga autoritetet kompetente per te pasur akses ne zonat e sistemimit dhe ruajtjes se bagazheve.

2. Pasagjereve mund ti lejohet aksesit per tek bagazhet e tyre te skanuara kur kjo eshte e nevojshme, duke siguruar qe ata jane te survejuar kudo ne menyre qe asnje artikull i ndaluar te:

- (a) mos te futet ne bagazhet ; ose
- (b) te mos hiqet nga bagazhet dhe te futet ne kabinen e avionit apo ne zonat e kufizuara te sigurise.

6. KARGO, KORIERI DHE PAKOT EKSPRES

6.1 Dorezuesi i rregulluar

Dorezues i rregulluar është ai, dorezimet e të cilit mund të jenë të identifikuar për tu imbarkuar eskuzivisht në të gjithë avionet e kargove.

6.2 Kualifikimet për agjentet e rregulluar

Dezignimi, miratimi apo listimi nga AAC

6.2.1 Në mënyrë që një subjekt të dezignohet, miratohet apo listohet si agjent i rregulluar, AAC duhet të sigurojë që procedura e mëposhtme është respektuar:

(a) Subjekti duhet të aplikojë pranë AAC për statusin e agjentit të rregulluar. Aplikuesi duhet të paraqesë një program sigurie pranë AAC-së. Programi duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga agjenti në mënyrë që të jetë në pajtueshëri si me këtë Udhezim ashtu edhe me Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil. Programi duhet gjithashtu të përshkruajë se si në përputhje me këto metoda dhe procedura, vete agjenti bën monitorimin.

Aplikuesi duhet gjithashtu të paraqesë një deklaratë me shkrim për angazhimin e tij për të mbajtur standartet e sigurisë sic janë të theksuara në programin e tij dhe të njoftojë AAC-në menjëherë për çdo ndryshim në këtë program. Kjo deklaratë duhet të firmoset nga përfaqësuesi ligjor ose nga personi përgjegjës për sigurinë.

(b) AAC duhet të ekzaminojë programin e sigurisë për të siguruar që masat e sigurisë të theksuara në program janë në baze të standarteve të kerkuara. AAC duhet të bëjë një verifikim për kushtet paraprake që aplikantët duhet të plotësojnë në mënyrë që të vendosë nëse aplikuesi është në gjendje të përmbushë kërkesat e këtij Udhezimi ashtu edhe të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil.

(c) Nëq AAC vlerëson se janë përmbushur kërkesat e përshikuara në pikat (a) dhe (b), ai mund të dizegnojë, miratojë ose listojë agjentin si agjent i rregulluar për vende specifike.

6.2.2 Një inspektim nga AAC në ambientet e agjentit të rregulluar mund të konsiderohet si një verifikim në vend për qëllim të pikës 6.2.1 (b).

6.2.3 Nëse AAC vlerëson se agjenti i rregulluar nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat e këtij Udhezimi ashtu edhe të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, anulon statusin e agjentit të rregulluar.

6.3 Kontrollët e Sigurisë

6.3.1 Kur kargo skanohet sipas standarteve të përgjithshme baze, agjentët ose transportuesit ajrorë duhet të:

(a) përdorin mjetet apo metodat me të pershtatshme për të zbuluar artikuj të ndaluar, duke marrë në konsideratë natyrën e ngarkesës; dhe

(b) të garantojnë që pajisjet ose metodat e përdorura janë të një standarti të mjaftueshëm që sigurojnë që asnjë artikull i ndaluar është fshehur në kargo.

6.4 Kriteter per nje dorezues te njohur

6.4.1 Deklarata e dorezuesit te njohur duhet te behet nje here ne vit me shkrim duke perdorur formen standarte te miratuar nga AAC . Deklarata duhet te perfshije certifikaten qe dorezimet nuk pembajne ndonje artikull te ndaluar. Dorezuesi i njohur mban pergjegjesi te plote per deklaraten e tij.

6.4.2 Kur nje dergese permban ndonje artikull te ndaluar, dorezuesi i njohur duhet qe ne cdo kohe te vertetoje me shkrim tek agjenti i rregulluar apo transportuesi ajror qe dergesa permban artikuj te tille.

6.4.3 Nese dorezuesi i njohur nuk eshte me ne gjendje te permbushë detyrimet e tij, atehere statusi i dorezuesit te njohur duhet anulohet nga AAC apo nga agjenti i rregulluar ose transportuesi ajror pergjegjes per miratimin.

6.5 Transporti i kargos ne avion

6.5.1 Ne menyre qe nje agjent i rregulluar ose nje transportuesi ajror te emerziej nje subjekt si nje dorezues i rregulluar, eshte e nevojshem qe :

(a) Subjekti duhet te paraqese nje deklarate te angazhimeve te firmosur, ku deklarone qe:
— konfirmon marrjen e instruksioneve kombetare per sigurine e godines, personelit dhe transportit,
— garanton qe instruksionet kombetare per sigurine i jane komunikuar stafit qe punon ne ate godine.

— e mban kargon te sigurve derisa i dorezohet agjentit te rregullt apo transportuesit ajror,
— pranon qe dergesat mund ti nenshtrohen kontroleve te sigurise, duke perfshire skanimin, dhe
— pranon inspektime te palajmeruara nga AAC ne menyre qe te vleresohet nese dorezuesi i rregulluar i permbush instruksionet kombetare.

Subjekti duhet te emerziej te pakten nje person pergjegjes per sigurine ne godinen e tij dhe duhet te informoje agjentin e rregulluar ose transportuesin ajror per emrin e ketij personi dhe menytrat e kontaktit.

(b) Agjenti i rregullt apo transportuesi ajror duhet te vendose detajet e meposhtme per subjektin:

— detajet e kompanise, duke perfshire adresen e biznesit te deklaruar,
— natyren e biznesit,
— menytrat e kontaktit, duke perfshire ato te personave pergjegjes per sigurine,
— numrin e references se kompanise ose numrin e regjistrimit, dhe
— llogarite bankare.

(c) Nqs agjenti i rregulluar apo transportuesi ajror mjaftohet me informacionin e siguruar ne pikat

(a) dhe (b), atehere subjekti mund te emerziej si dorezues i rregulluar.

6.5.2 Agjenti i rregulluar apo transportuesi ajror duhet te mbaje nje database me informacionin sipas pikes 6.5.1(b). Databaza duhet te jete e disponueshme per inspektim nga AAC.

6.5.3 Nese agjenti i rregulluar apo transportuesi ajror vlereson se dorezuesi pergjegjes nuk eshte ne gjendje te permbushë instruksionet kombetare, ai duhet te anulloje statusin e dorezuesit te rregulluar.

7. REKRUTIMI DHE TRAJNIMI I STAFIT

7.1 Programi Kombetar i Trajnimit te Sigurise se Aviacionit

Programi Kombetar i Trajnimit te Sigurise se Aviacionit perfshin nevojat e trajnimit per trajtimin e pasagjereve te padisciplinuar.

7.2 Personeli i sigurise

7.2.1 Transportuesi ajror dhe menaxhimi i sigurise se aeroportit

1. AAC duhet te garantoje qe cdo aeroport dhe transportues ajror duhet te kete menaxhim te pershtatshem te sigurise. AAC duhet te garantoje qe ka nje organizim te pershtatshem te menazhimit te sigurise. Menaxheret kryesore pergjegjes per pajtueshmerine e sigurise te transportuesve ajrore apo aeroportive duhet te zoterojne nivelin e nevojshem te kualifikimit, njohurise dhe eksperiences, ketu duhet te perfshihen:

- (a) eksperience ne operimet e sigurise te aviacionit civil, ose;
- (b) eksperience nga fusha te tjera te sigurise, si psh ne zbatimin e ligjit, ushtarake etj; dhe
- (c) certificate ose nje miratim ekuivalent nga AAC; dhe
- (d) njohuri ne fushat e meposhtme:
 - sistemet e sigurise dhe akses kontrolli,
 - sigurine ne toke dhe gjate fluturimit,
 - armet dhe artikujt e ndaluar,
 - njohuri mbi terrorizmin.